



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2024

**PËR  
SEKTORIN E FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, LARGIMIT, GRUMBULLIMIT  
E TRAJTIMIT TË UJRAVE TË NDOTUR URBAN**

Mbështetur në nenet 78, 81 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Objekti i ligjit**

Ky ligj ka si objekt të përcaktoj aspektet organizative, si dhe rregullat dhe normat që do të garantojnë sigurimin e ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane në cilësinë optimale.

**Neni 2  
Qëllimi i ligji**

1. Ky ligj ka si qëllim:

- a) krijimin e mekanizmave që sigurojnë kushtet optimale dhe garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban;
- b) ndërtimi i kornizës institucionale, në nivel kombëtar e vendor, ku përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e secilit institucion në kuadrin e përmbushjes së funksioneve politikëbërëse, rregullatore, menaxheriale dhe operacionale;
- c) ngritjen e mekanizmave që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimit të burimeve ujore në kuadër të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban;

- d) krijimin e mekanizmave, që mundësojnë ofrimin e një shërbimi sa më cilësor, si dhe promovimin e mbrojtjes së interesave të konsumatorit.

### **Neni 3 Parimet e zhvillimit të sektorit**

1. Sektori i furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane mbështetet mbi parimet e mëposhtme:

- a) parimin e gëzimit të së drejtës së këtij shërbimi nga çdo qytetar në mënyrë të barabartë, të sigurtë dhe të përballueshme, si dhe ndërmarrjen e politikave lehtësuese për shtresat në nevojë.
- b) parimin e decentralizimit dhe të autonomisë vendore.
- c) parimin e rikuperimit të kostove dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorëve të shërbimit.
- d) parimin mbi eficiencën, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e investimeve.
- e) parimin e ekonomisë qarkulluese, mbrojtjes së mjedisit, me qasjen ndotësi pagan.
- f) parimin e bashkëpunimit, subsidiaritetit dhe bashkërendimit të nismave ndërmjet niveleve qeverisëse dhe të gjithë aktorëve.
- g) parimin e transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në vendimmarrje.
- h) parimin e përgjegjësisë direkte të të licencuarit për ofrimin e shërbimit.
- i) parimin e mbështetjes mbi bazë performance.

### **Neni 4 Përkufizimet**

Termat, shkurtimet dhe përkufizimet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. “Agjencia kombëtare, përgjegjëse për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane” është një person juridik, publik, në varësinë e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, që zhvillon veprimtarinë e saj, sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. “Agjencia përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore” është një person juridik, publik, përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare në fushën e administrimit të burimeve ujore.
3. “Enti Rregullator i Ujit” (ERRU) është institucioni përgjegjës për rregullimin e sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban.

4. “Aksesi i palëve të treta” është e drejta e përdorimit të sistemit të rrjetit furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, të një zonë shërbimi nga palë të treta, në përputhje me parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit, kundrejt tarifave të miratuara.
5. “Furnizimi me ujë të pijshëm, largimi, grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotur urban”, është tërësia e shërbimeve të ofrura nga operatorët, apo subjekte të tjera të parashikuara në këtë ligj, që sigurojnë për konsumatorët familjarë, publikë e privatë, nxjerrjen, mbajtjen, ruajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit sipërfaqësor, ose nëntokësor, largimin, grumbullimin dhe përpunimin e ujërave të ndotur urban, të cilat më pas shkarkohen në ujërat sipërfaqësore.
6. “Licencë” është akti administrativ, i cili autorizon një operator, për ushtrimin veprimtarisë në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban, në një zonë shërbimi të caktuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
7. “Lidhje e paautorizuar” është lidhja e konsumatorit në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urbane, pa patur një kontratë me operatorin.
8. “I licencuar” është operatori i pajisur me licencë për kryerjen e një veprimtarie, në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
9. “Komisioni Kombëtar i Rregullimit”, ose “Komisioni”, është organi kolegjal vendimmarrës i ERRU-së, i zgjedhur sipas dispozitave të këtij ligji.
10. “Konsumator” është një konsumator familjar, ent publik, ose privat, i cili përdor shërbimet e ofruara të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban.
11. “Konsumator familjar” është konsumatori, që përdor shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban, vetëm për qëllimet tij familjare, pa përfshirë konsumin për veprimtari tregtare.
12. “Konsumator publik” është konsumatori, që përfaqëson një entitet publik, apo shtetëror, qendror, apo vendor.
13. “Konsumator privat” është konsumatori, që kryen një veprimtari tregtare, ose jofitimpruese, që rregullohet sipas legjislacionit për organizatat jofitimpruese dhe përdor shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban.

14. “Kontrata e performancës” është një marrëveshje që shërben si instrument për të nxitur performancën e mirë të operatorëve në ofrimin e shërbimit, e cila përcakton objektivat që duhet të arrihen për t’u konsideruar si performancë pozitive.
15. “Operator” është shoqëria aksionare e krijuar dhe licencuar me qëllim kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura urbane në zonën e saj të shërbimit, si dhe çdo operator tjetër i organizuar në formën e shoqërisë aksionare, i licencuar nga ERRU-ja, pavarësisht nëse është me kapital shtetëror apo privat.
16. “Operatori i alternativës së fundit” është shoqëria aksionare, pavarësisht llojit të kapitalit, shtetëror apo privat, që ka detyrimin të marrë përsipër ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, si dhe largimin, grumbullimin, dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane, për një, ose më shumë zona shërbimi, në rast të mosperformancës nga operatori i licencuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
17. “Partneritet publik privat” është marrëveshja koncesionare, ose marrëveshja e partneritetit publik privat, ndërmjet autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik privat, siç përcaktohet në legjislacionin për partneritetin publik privat.
18. “Pika e lidhjes” është pika e përcaktuar nga operatori i shërbimit, që lidh objektin e një konsumatori me rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm.
19. “Sektori” është sektori i furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
20. “Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm” është tërësia e elementeve, që përdoren për furnizimin me ujë të konsumatorëve, sipas manualeve teknike në fuqi.
21. “Sistem grumbullimi” është tërësia e elementeve që përdoren për grumbullimin dhe transportimin e ujrave të ndotura urbane, sipas manualeve teknike në fuqi.
22. “Sistemi i trajtimit të ujërave të ndotur urbane” është tërësia e elementeve që përdoren për trajtimin e ujërave të ndotur urbane, sipas manualeve teknike në fuqi.
23. “Subjekt i kompetencave të përbashkëta” (SKP) është një shoqëri tregtare e krijuar nga dy, ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe/ose institucioneve qendrore, me qëllim kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, si dhe largimin, grumbullimin, dhe

trajtimin e ujërave të ndotur urban, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të ligjit kuadër për vetëqeverisjen vendore.

24. "Shërbimi" është shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban.
25. "Ujë i pijshëm" është uji i përcaktuar për konsum njerëzor, sipas përcaktimeve në ligjin për burimet ujore.
26. "Ujëra të ndotura urban" janë ujërat e ndotura shtëpiake, ose përzierja e ujërave të ndotura shtëpiake me ujërat e ndotura industriale, ose ujërat rrjedhëse të reshjeve.
27. "Ujëra të ndotura shtëpiake" janë ujërat e përdorura nga zonat rezidenciale dhe sektori i shërbimeve, që e kanë origjinën kryesisht nga nevojat personale dhe veprimtaritë familjare.
28. "Ujëra të ndotura industriale" janë ujërat që shkarkohen nga një objekt, pasi përdoren për të zhvilluar veprimtari tregtare ose industriale, përveç ujërave të ndotura shtëpiake dhe ujërave të reshjeve.
29. "Ujërat e shiut" janë ujërat që krijohen nga rënia e reshjeve natyrore, sipas përcaktimeve në ligjin për burimet ujore.
30. "Zonë shërbimi" është territori administrativ i një ose më shumë bashkive, në të cilën një operator është licencuar për kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm si dhe për largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotur urban, sipas dispozitave të këtij ligji.

## **Neni 5**

### **Fusha e veprimit dhe përjashtimet**

1. Ky ligj përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat institucionale lidhur me politikën e zhvillimit dhe rregullimit, të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe zbatohet për të gjithë operatorët e licencuar, që ofrojnë këto shërbime, pavarësisht formës së organizimit.
2. Ky ligj nuk zbatohet:
  - a) Për menaxhimin e burimeve ujore dhe autorizimet që kërkohen për shfrytëzimin dhe përdorimin e rezervave ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore, për qëllim të sigurimit të ujit të pijshëm.
  - b) Për sistemet individuale të shfrytëzimit të ujit për nevojat e një konsumatori, kur këto sisteme janë ndërtuar nga vetë konsumatori, me leje nga agjencia përkatëse e basenit ujor, në pamundësi të gëzimit të shërbimit nga operatori i ofrimit të shërbimit të

furnizimit me ujë të pijshëm, të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.

- c) Për personat që ushtrojnë veprimtari tregtare të shitjes së ujit të pijshëm të ambalazhuar.

## **Kreu II**

### **Kuadri institucional i sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane**

#### **Neni 6**

##### **Këshilli i ministrave**

1. Këshilli i ministrave përcakton drejtimin kryesor dhe politikat e përgjithshme të zhvillimit të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, në përputhje me objektivat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe të përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve.
2. Këshilli i ministrave miraton strategjinë kombëtare dhe dokumenteve të tjera strategjike në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.

#### **Neni 7**

##### **Ministria përgjegjëse për infrastrukturën**

1. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën harton dhe zbaton politikat dhe programet e zhvillimit të sektorit. Ajo ndjek dhe siguron zbatimin dhe përmbushjen e funksioneve dhe detyrimeve të institucioneve në varësi të saj.
2. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën:
  - a) Përgatit dhe propozon aktet ligjore dhe nënligjore, të nevojshme për të garantuar kushtet optimale dhe një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit.
  - b) Harton dhe ndjek zbatueshmërinë e strategjisë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - c) Harton, në përputhje me strategjinë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, programet buxhetore dhe planet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata kombëtare për zhvillimin e sektorit.
  - d) Koordinon dhe shpërndan mbështetjen financiare, për investime apo asistencë teknike, në përputhje me politikat kombëtare dhe ato të nxitjes së performancës.

- e) Koordinon punën me strukturat e qeverisjes qendrore për të patur një bashkërendim masash sa më efikas.
- f) Bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe merr pjesë në krijimin e mekanizmave që sigurojnë bashkëpunimin midis tyre, sipas parashikimit të dispozitave të këtij ligji, ligjit për vetëqeverisjen vendore, si dhe marrëveshjeve, që kanë si objekt krijimin e këtyre mekanizmave;
- g) Bashkëpunon me ERRU-në, për të arritur objektivat e strategjisë kombëtare të sektorit furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.

### **Neni 8** **Ministria përgjegjëse për mjedisin**

Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe turizmin harton dhe zbaton politikat që synojnë mbrojtjen e mjedisit, në kuadër të mbrojtjes së cilësisë së burimeve ujore, të normave të shkarkimit në mjedis të ujërave, si dhe të aspekteve të tjera, sikurse është përcaktuar në legjisllacionin në fuqi.

### **Neni 9** **Ministria përgjegjëse për shëndetin publik**

Ministria përgjegjëse për shëndetin publik harton dhe monitoron kërkesat e cilësisë për ujin e pijshëm, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 10** **Ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale**

Ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale nxit dhe harton politika kombëtare mbështetëse dhe lehtësuese për aspekte të ndryshme të shërbimit që përfitojnë shtresat në nevojë.

### **Neni 11** **Agjencia përgjegjëse për burimet ujore**

Agjencia përgjegjëse për burimet ujore në bashkëpunim me SHGJSH përcakton kushtet e përdorimit të trupave ujorë të destinuar për konsum njerëzor, si dhe është përgjegjëse nëpërmjet organeve të menaxhimit të burimeve ujore, për lëshimin e lejeve dhe autorizimeve, në përputhje me ligjin për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

**Neni 12**  
**Agjencia kombëtare përgjegjëse për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin,  
grumbullimin e trajtimin e ujërave të ndotura urbane**

1. Agjencia është person juridik publik, në varësi të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën.
2. Agjencia ka përgjegjësitë dhe kompetencat e mëposhtme:
  - a) Mbështet nga pikëpamja teknike ministrinë e linjës për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të zhvillimit të sektorit.
  - b) Zbaton detyrimet për përmbushjen e objektivave strategjike në kuadër të strategjisë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe programeve të zhvillimit të sektorit;
  - c) Ushtron çdo kompetencë të ngarkuar nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për infrastrukturën.
  - d) Bashkëpunon me ERRU-në për zbatimin e planeve të zhvillimit të sektorit.

**Neni 13**  
**Enti Rregullator i Ujit**

1. ERRU-ja është përgjegjës për rregullimin e sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane. ERRU është autoriteti përgjegjës për licencimin e operatorëve që ofrojnë këto shërbime dhe për vendosjen e tarifave për konsumatorët.
2. Mënyra e organizimit, funksionimit, si dhe përgjegjësitë e ERRU-së përcaktohen në kreun VI, të këtij ligji.

**Neni 14**  
**Njësitë e vetëqeverisjes vendore**

Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë përgjegjëse për:

- a) Krijimin e shoqërive aksionare/ operatorëve, përgjegjëse për kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit, dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.



- b) Miratimin e bashkimit të operatorëve nën juridiksionin e tyre, me një ose më shumë operatorë të tjerë, sipas planit të agregimit, i cili përcaktohet dhe dakordësohet me marrëveshje, midis njësisive të vetëqeverisjes vendore dhe/ose qendrore, në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore.
- c) Miratimin e marrëveshjeve për vendosjen e objektivave të performancës, që propozohet nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën.
- d) Pagimin e detyrimeve, që operatori i ka të tretëve, kur ata nuk kanë aftësi paguese, në rast se zotërojnë të gjithë aksionet e operatorit. Në rast se zotërojnë vetëm një pjesë të aksioneve të operatorit, aplikohen kushtet e dakortësuar në marrëveshjen e krijimit të SKP-së.
- e) Mbështetjen e operatorit në procesin e miratimit të licencimit sipas dispozitave të këtij ligji.
- f) Mbështetjen e operatorit në procesin e miratimit të tarifave sipas dispozitave të këtij ligji dhe shprehjen e mendimit mbi propozimin e operatorit për nivel të ri tarifor brenda 30 ditëve nga momenti i kërkesës së operatorit. Në rast se njësitë e qeverisjes vendore nuk shprehen brenda këtij afati, kjo nuk përbën pengesë për vijimin e procedurës nga ana e ERRU-së.
- g) Koordinimin e planifikimit urban me zhvillimin e infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit e trajtimit të ujërave të ndotura urbane, në territorin administrativ nën juridiksionin e tyre.
- h) Sigurimin e mbështetjes së nevojshme financiare për operatorët, sipas planit të biznesit të miratuar, kur ky plan nuk mund të mbulohet nga të ardhurat e vetë operatorit.
- i) Hartimin dhe zbatimin e politikave mbështetëse dhe lehtësuese për shtresat në nevojë.

### **Neni 15**

#### **Operatori i ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane**

1. Operatorët janë përgjegjës për:
  - a) Ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe shitjen e tij.
  - b) Ofrimin e shërbimit të largimit, grumbullimit si dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - c) Operatorët janë përgjegjës për shitjen e ujit me shumicë.

- d) Mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm dhe impianteve të trajtimit të tyre, kur është rasti.
  - e) Mirëmbajtjen e sistemeve të largimit, grumbullimit të ujërave të ndotura urbane, si dhe të impianteve të trajtimit të tyre.
2. Statuti i operatorëve miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
  3. Operatorët pajisen me licencë të lëshuar nga ERRU-ja, sipas këtij ligji. Operatorët të cilët nuk janë pajisur përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruar të pajisen me licencë jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi i këtij ligji.

### **KREU III**

## **MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE, ASETVE DHE I INFORMACIONIT**

### **Neni 16**

#### **Programi kombëtar i trajnimit dhe certifikimit të burimeve njerëzore**

1. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën nxit dhe mbështet rritjen e ekspertizës së kapaciteteve njerëzore, në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit, dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban, duke konceptuar dhe ndërtuar platforma kombëtare, për këtë qëllim.
2. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën përcakton mekanizmat institucional të qëndrueshëm për zbatimin e programit të trajnimit dhe certifikimit.
3. Mënyra e funksionimit të programit për trajnimin dhe certifikimin të punonjësve në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe administrimit të tij, përcaktohet me udhëzimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën.

### **Neni 17**

#### **Pronësia e asetve dhe aksioneve**

1. Janë pronë e paluajtshme publike dhe i përkasin shtetit:
  - a) Sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe impiantet e trajtimit të tyre.
  - b) Sistemet e largimit, grumbullimit të ujërave të ndotura urbane.
  - c) Impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - d) Të gjitha ndërtesat që përdoren nga operatori për kryerjen e shërbimeve.

2. Asetet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, regjistrohen në regjistrin e pronave të paluajtshme, nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, me pronar këtë të fundit, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit. Në rast të krijimit të SKP-ve me kapital edhe të qeverisjes qendrore, pronësia e aseteve dhe pjesa takuese e palëve, përcaktohen në marrëveshjen e krijimit të SKP-së.
3. Asetet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, i jepen në përdorim, pa pagesë operatorit nën juridiksionin e njësisë së qeverisjes vendore. Në rast të krijimit të SKP-së me kapital edhe të qeverisjes qendrore, ose në rast të një operatori me kapital privat, kushtet e dhënies në përdorim të aseteve, përcaktohen në marrëveshjet përkatëse.
4. Aksionet e operatorit, në juridiksionin e njësisë së qeverisjes vendore janë në pronësi të tyre. Në rast të krijimit të SKP-së me kapital edhe të qeverisjes qendrore, përcaktohen në marrëveshjet përkatëse.
5. Aksionet janë të formës nominative dhe pronësia mbi to është e patjetërsueshme, me përjashtim të rasteve kur e drejta e pronësisë i kalon një organi të qeverisjes vendore ose qendrore apo një operatori me kapital privat, sipas legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjes përkatëse.
6. Në rastet kur investimet kapitale kryhen nga qeverisja qendrore, pronësia mbi këto asete është e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, me përjashtim të rastit kur kjo e fundit ja kalon të drejtën e pronësisë njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast këto asete i jepen në përdorim, pa pagesë operatorëve.

### **Neni 18** **Sistemi i menaxhimit të aseteve**

1. Asetet e përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji, si dhe çdo aset tjetër i paluajtshëm dhe/ose i luajtshëm në përdorim, apo në pronësi të operatorëve, regjistrohet në sistemin kombëtar të menaxhimit të aseteve.
2. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën krijon sistemin kombëtar, të menaxhimit të aseteve të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e ligjit.
3. Agjencia kombëtare për furnizimin me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura administron dhe monitoron sistemin kombëtar të menaxhimit të aseteve.

4. Mënyra e funksionimit të sistemit dhe administrimit të tij përcaktohen me udhëzimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën brenda një viti nga hyrja në fuqi e ligjit.
5. Njësitë e qeverisjes vendore dhe operatorët janë përgjegjëse për plotësimin e të dhënave në sistem, brenda 1 viti nga fillimi i funksionimit të tij.

### **Neni 19** **Sistemi i integruar i informacionit**

1. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën ngre sistemin e integruar të informacionit të sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit, dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, brenda një viti nga hyrja në fuqi e ligjit.
2. Agjencia qendrore për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin, grumbullimin dhe trajtimin të ujërave të ndotura administrojnë dhe monitorojnë sistemin e integruar të informacionit.
3. Mënyra e funksionimit të sistemit dhe administrimit të tij përcaktohet me udhëzimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën, brenda një viti nga hyrja në fuqi e ligjit.
4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe operatorët janë përgjegjëse për plotësimin e të dhënave në sistem, brenda 6 muajve, nga fillimi i funksionimit të tij, si dhe për përditësimin e tyre në vazhdimësi.
5. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën, nëpërmjet Agjencisë kombëtare për furnizimin me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin të ujërave të ndotura urbane, administrojnë dhe monitorojnë sistemin e integruar të informacionit.

## **KREU IV** **RREGULLIMI I OFRIMIT DHE OPERIMIT TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME** **UJË TË PIJSHËM, LARGIMIT, GRUMBULLIMIT DHE TRAJTIMIT TË** **UJËRAVE TË NDOTURA URBANE**

### **Neni 20** **Rregullimi i përgjithshëm**

1. Ofrimi i shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, kryhet nga operatorët.
2. Funksionimi i operatorëve rregullohet nga ky ligj, nga ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe nga akte ligjore e nënligjore, që kanë si objekt aspekte të caktuara të këtij shërbimi.

### **Neni 21**

## **Bashkëpunimi ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore**

1. Për kryerjen e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, në dobinë e përbashkët, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku, apo midis qarqeve të ndryshme, mund të ushtrojnë së bashku këtë funksion, nëpërmjet lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve, apo kontratave të përbashkëta, apo delegimit të kompetencave dhe përgjegjësi të veçanta njëra-tjetrës.
2. Elementet e marrëveshjes janë ato të përcaktuara në ligjin kuadër për vetëqeverisjen vendore.
3. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën me propozim të agjencisë kombëtare përgjegjëse të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, i paraqet njësive të vetëqeverisjes vendore, kur ky rezulton fizibël, planin e agregimit të dy ose më shumë operatorëve, i cili miratohet me marrëveshje midis njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve në ligjin për vetëqeverisjen vendore.
4. Në rast të miratimit të marrëveshjes së parashikuar në pikën 3 të këtij neni, ministria përgjegjëse për infrastrukturën mbështet financiarisht realizimin e agregimit sipas planit të propozuar prej saj, duke miratuar çdo vit, si zë të vecantë në buxhetin e saj detyrimin përkatës.
5. Në rastin kur marrëveshja e parashikuar në pikën 3 të këtij neni nuk miratohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, secila njësi e vetëqeverisjes vendore, mbetet përgjegjëse për buxhetimin e detyrimeve që dalin nga plani i zhvillimit i operatorit përkatës.

### **Neni 22**

#### **Bashkëpunimi ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore**

1. Dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, me njëra tjetrën, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët, për sigurimin e ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane brenda zonave respektive të shërbimit.
2. Në kuptimin e këtij ligji, subjekti i krijuar sipas pikës 1, quhet Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta.

3. Objekti i punës së SKP-së përcaktohet në marrëveshjen e përbashkët, midis palëve të përfshira në këtë subjekt, në funksion të kryerjes së shërbimit, ose përmbushjes së detyrimit të përbashkët për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin, grumbullimin, dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane.

### **Neni 23**

#### **Format e subjektit të kompetencave të përbashkëta**

1. SKP-ja, sipas parashikimeve të nenit 22 të këtij ligji, si dhe sipas parashikimeve të ligjit kuadër për vetëqeverisjen vendore mund të organizohet si një bord, ose shoqëri tregtare, i krijuar nga dy, ose më shumë njësi të qeverisjes vendore dhe/ose ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, me qëllim kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimin të ujërave të ndotura urbane, brenda zonave respektive të shërbimit, nën juridiksionin e bashkive pjesë e SKP-së.
2. Kur SKP-ja krijohet në formën e një shoqërie tregtare, që merr përsipër kryerjen e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit, dhe trajtimin të ujërave të ndotura urban, në një zonë të caktuar shërbimi, me pjesëmarrjen edhe të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, marrëveshja mund të parashikojë, përfshirjen e kësaj të fundit si aksionar i shoqërisë së re, nëpërmjet sigurimit të kapitalit të nevojshëm për financimin e investimeve kapitale të shoqërisë, në përputhje me dispozitat e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
3. Për rastet e SKP-ve të krijuara me pjesëmarrjen edhe të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, Këshilli i Ministrave miraton marrëveshje standarde.
4. SKP-ja e krijuar si një shoqëri tregtare, licencohet nga ERRU-ja sipas dispozitave të këtij ligji.

### **Neni 24**

#### **Kontrata e performancës**

1. Ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe autoriteteve të qeverisjes qendrore lidhen kontrata performance, të cilat përcaktojnë treguesit, që do të arrihen në bazë vjetore nga operatorët.
2. Kontratat e performancës nënshkruhen nga agjencia kombëtare për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin, grumbullimin dhe trajtimin të ujërave të ndotura urbane dhe njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

3. Në rastet e SKP-ve të krijuara me pjesëmarrjen edhe të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, kontrata e performancës nënshkruhet ndërmjet asamblesë së përgjithshme të operatorit dhe administratorit të tij.
4. Ministri përgjegjës për infrastrukturën miraton me udhëzim, çdo vit, brenda 9 mujorit kontratën tip të performancës, që do të nënshkruhet në vitin pasardhës ndërmjet palëve, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.
5. Objektivat e kontratës së performancës të lidhur sipas këtij neni, reflektohen në planin e biznesit të operatorëve përkatëse.

### **Neni 25** **Marrëveshjet koncesionare dhe partneriteti publik privat**

1. Dhënia me koncesion, apo me një marrëveshje të partneritetit publik privat, e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane bëhet në përputhje me ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat dhe aktet nënligjore, që përcaktojnë kërkesat dhe procedurat përkatëse.
2. Studimi përkatës i fizibilitetit i kryer nga njësi e vetëqeverisjes vendore përkatëse për dhënien me koncesion, ose nëpërmjet një marrëveshjeje të partneritetit publik privat, miratohet parimisht nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe nga ERRU-ja, brenda 3 muajve nga paraqitja e tij.
3. Vetëm pas marrjes së miratimit, sipas pikës 2 të këtij neni, njësi e vetëqeverisjes vendore vijon me procedurat e parashikuara në ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

### **Neni 26** **Operatori i alternativës së fundit**

1. Operatori i licencuar për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane është operatori, që ka detyrimin e shërbimit publik, të marrë përsipër shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe të largimit, grumbullimit e trajtimit të ujërave të ndotura urbane për një, ose më shumë zona shërbimi, në rast të mosperformancës nga operatori i licencuar.
2. Operatori i licencuar për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane mund të jetë me kapital shtetëror, ose privat dhe në çdo rast i nënshtrohet licencimit nga ERRU-ja për të ushtruar veprimtarinë në përputhje me kohëzgjatjen e përcaktuar në licencën e lëshuar prej tij.

3. Në rastet kur ERRU-ja vendos heqjen e licencës së një ose më shumë operatorëve, sipas dispozitave të këtij ligji, kryerja e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit e trajtimit të ujrave të ndotura urbane në zonën e shërbimit merret përsipër nga operatori i alternativës së fundit.
4. Në rastin kur Operatori i licencuar për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane është me kapital shtetëror, ERRU-ja me vendim të veçantë cakton një nga të licencuarit ekzistues me performancën më të mirë, ose krijimin e një operatori me kapital shtetëror, pronë e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, si operatori i alternativës së fundit, që ka detyrimin e shërbimit publik, të marrë përsipër shërbimet për një ose më shumë zona shërbimi.
5. Krijimi, vlera e kapitalit themeltar dhe statuti i operatorit me kapital shtetëror, që përcaktohet si operatori i alternativës së fundit, sipas pikës 3 të këtij neni, propozohen nga ministri përgjegjës për infrastrukturën dhe ministri përgjegjës për financën dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Operatori i licencuar për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane pajiset me licencë nga ERRU-ja sipas dispozitave të këtij ligji për zonën përkatëse të shërbimit.
7. Kushtet e shërbimit të përcaktuara sipas pikës 1 marrin parasysh gjendjen aktuale të sistemeve të grumbullimit, prodhimit dhe shpërndarjes e furnizimit me ujë të pijshëm dhe tarifatat dhe të ardhurat financiare të operatoreve të miratuara nga ERRU-ja, si dhe mbështetjen financiare që qeveria alokon në sipas programit buxhetor afatmesëm.

**KREU V**  
**KUSHTET E OFRIMIT TE SHËRBIMIT DHE SISTEMI I FURNIZIMIT ME**  
**UJË, TË PIJSHËM, LARGIMIT, GRUMBULLIMIT DHE TRAJTIMIT TË**  
**UJËRAVE TË NDOTURA URBANE**

**Neni 27**  
**Kushtet e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm**

1. ERRU-ja, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton kushtet e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët, që janë të detyrueshme për të gjithë operatorët, pavarësisht zonës së shërbimit që mbulojnë, numrit të konsumatorëve, apo statusit të tyre të pronësisë.



2. Kushtet e shërbimit të përcaktuara sipas pikës 1, marrin parasysh gjendjen aktuale të sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, tarifat dhe të ardhurat financiare të operatoreve të miratuara nga ERRU-ja, sikurse dhe mbështetjen financiare që qeverisja qendrore alokon sipas programit buxhetor afatmesëm.
3. Kushtet e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm të vendosura sipas këtij neni lidhen me:
  - a) Kërkesat për cilësinë e ujit të pijshëm dhe parametrat e miratuara nga autoritetet përgjegjëse për shëndetin publik.
  - b) Presionin e ujit në pikën e livrimit të tij tek konsumatorët fundorë.
  - c) Qëndrueshmërinë e furnizimit me ujë të konsumatorëve fundorë.
  - d) Numrin e ndërprerjeve të furnizimit me ujë dhe kohëzgjatjen e tyre.
  - e) Matjen e konsumit të ujit.
  - f) Afatin për trajtimin e kërkesave për lidhje të reja, ose rilidhjen e një konsumatori me rrjetin e furnizimit me ujë.
  - g) Afatin për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve nga operatorët.
4. ERRU-ja mund të përfshijë në kushtet e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm edhe elementë të tjerë përveç atyre të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, nëse e konsideron të nevojshme.

## **Neni 28**

### **Kushtet e shërbimit për largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane**

1. ERRU-ja përcakton dhe miraton brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kushtet e shërbimit për largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane që janë të detyrueshme për të gjithë operatorët, pavarësisht zonës së shërbimit që mbulon, numrit të konsumatorëve, apo statusit të tyre të pronësisë.
2. Kushtet e shërbimit të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane të vendosura sipas pikës 1 të këtij neni lidhen me:
  - a) Shpeshhtësinë e pastrimit të sistemit të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - b) Afatin për trajtimin e kërkesave për lidhje të reja të një përdoruesi/klienti me sistemin e largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - c) Afatin për trajtimin dhe riparimin e një defekti në sistemin e largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - d) Afatin për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të përdoruesve/klientëve.

- e) Detyrimin për ndërtimin e sistemeve grumbulluese/kolektore dhe impianteve të trajtimit të ujrave të ndotura për qendrat urbane me një numër të caktuar banorësh të parashikuar në këtë ligj.
- 3. ERRU-ja mund të përfshijë në kushtet e shërbimit të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura urbane edhe elementë të tjerë përveç atyre të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, nëse e konsideron të nevojshme.

### **Neni 29**

#### **Përbërja e sistemit publik të furnizimit me ujë të pijshëm**

1. Sistemi publik i furnizimit me ujë të pijshëm përbëhet nga:
  - a) impiantet e grumbullimit dhe prodhimit të ujit.
  - b) linjat kryesore, depot e përqendruara, linjat primare dhe sekondare të tubacionit që shërbejnë për transportin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm, nga prodhimi i ujit të pijshëm deri tek konsumatorët.
  - c) pajisjet e përhershme, apo të përkohshme, të instaluara në sistemin e furnizimit me ujë për qëllime matje marrje mostre dhe testimi të ujit të pijshëm.
2. Asnjë person ose individ i pa autorizuar, nuk lejohet të ndërhyjë, prekë, ndryshojë apo dëmtojë sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm.
3. Me propozim të ministrit përgjegjës për infrastrukturën, Këshilli Ministrave miraton kushte dhe norma teknike për projektimin dhe ndërtimin e veprave dhe impianteve të grumbullimit, prodhimit të ujit dhe sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm.

### **Neni 30**

#### **Plani për zhvillimin e sistemit**

1. Sistemi publik i furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura urbane zhvillohet mbi parimet e kostos më të ulët, në përputhje me planifikimin urban, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, të drejtat e pronësisë, si dhe mbështetur në rregullat teknike dhe të sigurisë të parashikuara në normat dhe standardet teknike në fuqi.
2. Operatorët në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore përgatisin planet e biznesit pesë vjeçare të investimeve dhe zhvillimit të sistemit publik të furnizimit me ujë të pijshëm, përfshirë sistemin e largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura urbane.

3. Planet e biznesit pesë vjecare, sipas pikës 2 të këtij neni, për zhvillimin e sistemit marrin parasysh:
  - a) strategjinë kombëtare të furnizimit me ujë të pijshëm dhe grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - b) planet vendore të zhvillimit të territorit.
  - c) nevojat e konsumatoreve për ujë.
  - d) gjendjen aktuale të rrjetit.
  - e) treguesit e performances.
  - f) burimet e financimit dhe aftësitë paguese të konsumatorëve brenda një zonë shërbimi.
4. ERRU-ja miraton modelin tip të planeve të biznesit, si dhe një rregullore të veçantë lidhur me procedurat dhe kriteret për paraqitjen, shqyrtimin dhe miratimin e tyre.

### **Neni 31**

#### **Zonat e mbrojtjes higjiëno-sanitare**

1. Për mbrojtjen e rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të aseteve të tij ndihmëse, si dhe për shmangien e rrezikut ndaj njerëzve, pasurisë dhe mjedisit, krijohen zonat e mbrojtjes higjiëno sanitare të burimeve ujore të caktuara për prodhimin e ujit të pijshëm dhe të sigurisë.
2. Shtirja e zonave të mbrojtjes higjiëno - sanitare, si dhe ndalimet dhe kufizimet e aplikueshme për këto zona, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetin publik dhe MIE (SHGJSH).

### **Neni 32**

#### **Impiantet e grumbullimit dhe prodhimit të ujit të pijshëm**

1. Operatorët janë përgjegjës për ndërtimin, instalimin dhe operimin e impianteve të tyre për grumbullimin, dhe prodhimin e ujit të pijshëm.
2. Impiantet e grumbullimit dhe prodhimit të ujit të pijshëm të tilla si burimet e ujit të pijshëm, veprat e marrjes, pus-shpimet, projektohen dhe ndërtohen në përputhje me normat dhe standardet teknike në fuqi, si dhe respektojnë kërkesat lidhur me shëndetin publik dhe mbrojtjen e mjedisit.

3. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën mbështet operatorët lidhur me gjetjen dhe sigurimin e burimeve financiare të nevojshme për ndërtimin ose zgjerimin e impianteve të grumbullimit dhe prodhimit të ujit të pijshëm.

### **Neni 33**

#### **Lidhja e dy rrjeteve të shpërndarjes së ujit të pijshëm**

1. Dy operatorë, zonat e shërbimit të të cilëve janë kufitar, mund të vendosin ndërtimin e një, ose më shumë linjave, që do të mundësonin lidhjen e dy rrjeteve të furnizimit me ujë të pijshëm.
2. Ndërtimi i një linje që lidh dy rrjetet përfshihet në planet e zhvillimit të dy operatorëve.
3. Kostot e investimit të linjës ndahen ndërmjet dy operatorëve në mënyrë proporcionale duke marrë parasysh gjatësinë si dhe kostot e secilit prej seksioneve që shtrihen në zonat përkatëse të shërbimit.
4. Operimi dhe përdorimi i një linje që lidh dy rrjete të shpërndarjes bëhet sipas një marrëveshjeje të miratuar nga ERRU-ja që përcakton rregullat për operimin e një linje që lidh dy rrjete të shpërndarjes.

### **Neni 34**

#### **Lidhja e konsumatorëve me rrjetin publik të furnizimit me ujë të pijshëm**

1. Lidhja e një konsumatori të ri me rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm bëhet vetëm me miratimin e operatorit, i cili përcaktojnë pikën e lidhjes.
2. Për çdo lidhje të re operatori lidhë një kontratë shërbimi me konsumatorin që paraqet kërkesën për lidhje.
3. Lidhja me rrjetin publik të furnizimit me ujë të pijshëm mund të jetë e përhershme, ose e përkohshme.
4. Çdo konsumator mund të ketë vetëm një lidhje me sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm për një objekt. Konsumatori është përgjegjës për instalimin dhe mirëmbajtjen e instalimeve të brendshme të furnizimit me ujë të pijshëm.
5. Në rastin kur operatorët zëvendësojnë rrjetin ose tubacionin në të cilin është lidhur një konsumator, ai është i detyruar të krijojë një pikëlidhje të re. Në çdo rast kostot e lidhjes së re mbuloohen nga konsumatori, ndërsa kostot e rilidhjes për shkak të investimeve të reja, që zëvendëson magjistralet rrugore të tubacioneve do të mbuloohen nga operatorët.

6. Në rast se objekti ka një lidhje të furnizimit me ujë të pijshëm nga rrjeti publik i furnizimit me ujë të pijshëm, ndalohet lidhja e sistemeve të pavarura individuale të furnizimit me ujë të pijshëm.

### **Neni 35**

#### **Marrëveshja e furnizimit me ujë të pijshëm me konsumatorët**

1. Operatori lidh marrëveshje për furnizimin me ujë të pijshëm me çdo konsumator në zonën e tyre të shërbimit.
2. ERRU-ja miraton marrëveshje tip për kategori të ndryshme konsumatorësh, të cilat zbatohen nga të gjitha operatorët të pajisur me licencë.
3. Për konsumatorët e shtresave në nevojë, operatori është i detyruar që të garantojë pa pagesë furnizimin me ujë të pijshëm për to, duke përcaktuar një normë minimale të nevojshme sipas standardit të miratuar nga ERRU-ja.

### **Neni 36**

#### **Lidhjet e paligjshme me rrjetin publik të furnizimit me ujë të pijshëm**

1. Operatori identifikojnë të gjitha lidhjet e paligjshme të subjekteve familjare, publike ose private dhe merr masa për shpërbërjen e tyre përfshirë sanksionet administrative sipas dispozitave të nenit 75 të këtij ligji.
2. Kur lidhja, ose ndërhyrja e paligjshme, ka shkaktuar dëme të konsiderueshme të rrjetit, operatori kërkon ndjekjen penale të kundërvajtësit sipas dispozitave të Kodit Penal.

### **Neni 37**

#### **Ndërprerja e ofrimit të shërbimit një konsumatori dhe rifillimi i ofrimit të tij**

1. Ndërprerja e furnizimit me ujë të pijshëm, apo/dhe ndërprerja nga rrjeti i largimit, grumbullimit e trajtimit të ujërave të ndotura urbane, të një konsumatori mund të bëhet me kërkesën e tij, ose me iniciativën e operatorit.
2. Operatori ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me ujë të pijshëm, apo/dhe ndërprerjen nga rrjeti i i largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane të një konsumatori në këto raste:

- a) Kur konsumatori nuk paguan detyrimet financiare, brenda afateve ligjore dhe sipas detyrimeve kontraktuale të furnizimit me ujë të pijshëm.
  - b) Kur konsumatori ndërhyt në mënyrë të paligjshme në rrjetin publik të furnizimit me ujë të pijshëm duke u furnizuar me ujë para matësit të ujit dhe/ose kur manipulon matësin, ose kur konsumatori ndërhyt në mënyrë të paligjshme në rrjetin e largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - c) Kur konsumatori krijon lidhje të pamiratuara nga operatori dhe bën dëmtime të çdo lloji të rrjetit publik të furnizimit me ujë të pijshëm, ose në rrjetin e largimit, grumbullimit e trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
3. Në rastin e ndërprerjes sipas pikës 2 të këtij neni, kontrata e operatorit me konsumatorin, pezullohet.
  4. Operatori kryen rilidhjen në rrjet vetëm nëse konsumatori ka përmbushur detyrimet e tij.
  5. ERRU-ja miraton rregulla të veçanta që zbatohen për ndërprerjet e lidhjeve të konsumatorëve dhe rilidhjen e tyre, përfshirë njoftimin e konsumatorit, afatet dhe pagesat për rilidhjen, të cilat marrin parasysh kategorinë e konsumatorëve.

### **Neni 38**

#### **Marrëveshja me konsumatorët debitorë**

1. Pavarësisht përcaktimeve të nenit 37, operatori mund të vendos të mos ndërpresë furnizimin e një konsumatori debitor ndaj operatorit në rast se konsumatori bie dakord që të nënshkruajë një marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve të tij të mëparshme me këste për një periudhë të caktuar.
2. Operatori lidh një marrëveshje sipas pikës 1 të këtij neni vetëm me kushtin që konsumatori, përveçse pagesës së detyrimeve të mëparshme, bie dakord edhe që të paguajë rregullisht të gjitha faturat e ardhshme mujore.
3. Operatori përcakton skemën e shlyerjes së detyrimeve cila duhet të miratohet dhe përmbushet nga konsumatori.

### **Neni 39**

#### **Ndërprerja e furnizimit me ujë të pijshëm në situata emergjence**

1. Në rastet e emergjencave në furnizimin me ujë të pijshëm të krijuara për shkaqe që nuk varen nga operatori, ky i fundit mund të ndërpresë furnizimin me ujë të konsumatorëve për një periudhë kohe deri në përfundimin e situatës së emergjencës.
2. Situata e emergjence janë rastet kur kërcënohet seriozisht jeta dhe shëndeti i njerëzve dhe çënohet seriozisht mjedisi.
3. Gjatë një situatë emergjence operatori, në bashkëpunim me njësinë e vetëqeverisjes, vendore merr masat e nevojshme për furnizimin me ujë të pijshëm pa pagesë të konsumatorëve të prekur nëpërmjet mënyrave alternative.
4. Ministria përgjegjëse e shëndetit publik koordinon dhe harton veprimet korrekte në rast të shpërthimeve epidemike dhe situatave të tjera emergjente ku çënohet siguria e shëndetit të njerëzve.
5. ERRU-ja miraton rregulla specifike që ndiqen nga operatorët në rastet e situatave të emergjencës.

#### **Neni 40**

#### **Matja e konsumit të ujit**

1. Uji në rrjet, dhe uji i konsumuar nga konsumatorët fundorë matet nëpërmjet matësave të ujit, në përputhje me parashikimet e legjislacionin në fuqi për metrologjinë.
2. Në çdo pikë lidhje, operatori instalon matësa uji, që mundësojnë regjistrimin e sasisë së ujit të konsumuar nga konsumatori. Matësi i ujit përmbush kërkesat teknike dhe saktësinë e përcaktuar në legjislacionin për metrologjinë.
3. Matësi instalohet në vende të dukshme dhe të sigurta, të miratuara nga operatori.
4. Pajisja me ujëmatës në investimet e reja në rrjetin publik të furnizimit me ujë të pijshëm mbulohet nga një zë i dedikuar në investimin e planifikuar.
5. Operatorët janë përgjegjës për veprimtarinë e matjes dhe leximit të matësave të ujit në pikën e marrjes nga burimi uhor si dhe në rrjetet e shpërndarjes. Në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se një muaj, operatorët llogarisin nëpërmjet rakordimeve sasinë e ujit të prodhuar. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj.
6. Operatorët janë përgjegjës për veprimtarinë e matjes dhe leximit të matësave tek konsumatorët final. Në rast se të dhënat e matjes për konsumatorin janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se një muaj, operatorët

llogarisin vlera reference zëvendësuese, historikun e faturimit të konsumatorit përkatës. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj.

7. Kosto e zëvendësimit të matësit, mbulohet nga konsumatori dhe përfshihet në tarifën mujore të pagesës së faturës së ujit.
8. Nëse operatori konstaton ndërhyrje të paligjshme në matës nga ana e konsumatorit, ai merr masa të menjëhershme për riparimin dhe zëvendësimin e matësit në të cilin është ndërhyrë, përlllogaritë dëmin ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme dhe zbaton procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
9. Operatori mund të kontraktojnë persona të tretë të specializuar për kryerjen e veprimtarisë së matjes dhe/ose leximit të matësve në rrjetet e tyre përkatëse, nëse ky kontraktim sjell përfitime tek konsumatorët.

#### **Neni 41**

##### **Verifikimi i matësve**

1. Matësit e ujit verifikohen përpara instalimit dhe vënies në përdorim në përputhje me legjislacionin e metrologjisë.
2. Verifikimi i matësit mund të realizohet me iniciativë të operatorit, ose me kërkesë të konsumatorit. Në çdo rast gjatë verifikimit duhet të jetë i pranishëm përfaqësuesi i operatorit.
3. Kostot financiare të verifikimit përpara vënies në përdorim, verifikimin periodik të matësit apo verifikime të kërkuara nga operatorët, mbulohen nga këta të fundit.
4. Në rastet kur verifikimi kërkohet të kryhet nga konsumatori, kostoja financiare duhet të mbulohet nga vetë abonentit sipas tarifave të miratuara nga aktet nënligjore në fuqi.

#### **Neni 42**

##### **Faturimi**

1. Operatorët janë të detyruar të faturojnë sasinë e konsumuar të ujit nga konsumatorët sipas leximit të matësit.
2. Formatit i faturës së lëshuara nga operatorët miratohet nga Ministria e Financave.
3. Afati, periodiciteti i lëshimit të faturës si dhe pagesa e saj përcaktohet nga operatorët dhe dakordësohet nga konsumatori në marreveshjen e furnizimit me ujë të pijshëm.



4. Fatura e shërbimit të furnizimit të ujit të pijshëm dhe largimit dhe përpunimit të ndotura urbane është titull ekzekutiv.

### **Neni 43**

#### **Mbrojtja e konsumatorëve**

1. Konsumatorët e ujit, gëzojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre në përputhje me këtë ligj si dhe të legjislacionit në fuqi, që rregullon mbrojtjen e konsumatorëve.
2. Nuk lejohet asnjë lloj sjellje diskriminuese e operatorëve ndaj konsumatorëve. Gjatë kryerjes së veprimtarive të tyre, operatorët veprojnë në mënyrë të tillë që të sigurojnë trajtim të barabartë të të gjithë konsumatorëve.
3. Konsumatorët kanë të drejtë:
  - a) Të njoftohen paraprakisht për çdo ndryshim të kushteve të marrëveshjes së furnizimit me ujë të pijshëm.
  - b) Të marrin informacion të plotë për çmimet, tarifën, termat dhe kushtet standarde në lidhje me aksesin dhe ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit e trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - c) Të mbrohen prej metodave të padrejta të faturimit.
  - d) Të përfitojnë nga procedura transparente e të thjeshta për trajtimin e ankesave të tyre.

### **Neni 44**

#### **Cilësia dhe higjiena e ujit të pijshëm**

1. Operatorët marrin të gjitha masat e nevojshme për garantimin e cilësisë dhe higjenës së ujit të pijshëm brenda zonës së tyre të shërbimit.
2. Operatorët janë përgjegjës për mbrojtjen higjieno sanitare të rezervuarëve, stacioneve të pompimit, depove të ujit dhe rrjetit shpërndarës deri tek ujëmatësi i instaluar, sipas standardeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
3. Rregullat për cilësinë e ujit të pijshëm të cilet garantojnë shëndetin e konsumatorëve, miratohen nga Këshilli i Ministrave.
4. Për të siguruar cilësinë e ujit të pijshëm, operatori kryen monitorimin e brendshëm të cilësisë së ujit të pijshëm që ai furnizon, sipas kërkesave të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi.

5. Në rast të mospërmbushjes së standardeve të cilësisë dhe higjenës së ujit ERRU-ja mund të vendosë heqjen e licencës sipas dispozitave të nenit 68 të këtij ligji.

#### **Neni 45**

##### **Përbërja e sistemit të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane**

1. Sistemi publik i largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane përbëhet nga:
  - a) rrjetet e shkarkimit të ujërave të ndotura dhe kolektorët e largimit të tyre.
  - b) impiantet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - c) stacionet e pompimit.
2. Operatorët janë përgjegjëse për administrimin, mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit publik të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane për zonën e tyre të shërbimit.
3. Ndërhyrja në mënyrë të paautorizuar në rrjet apo dëmtime të rrjetit kur nuk përbën veprë penale është kundërvajtje administrative referuar nenit 75 të këtij ligji.
4. Projektimi dhe ndërtimi i sistemeve të largimit, grumbullimit dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura bëhet sipas standardeve dhe norma teknike në fuqi.

#### **Neni 46**

##### **Lidhja e përdoruesve me sistemin e largimit, grumbullimit dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane**

1. Çdo konsumator, në pronën e të cilit gjenerohet ujë i ndotur, është i detyruar të lidhë pronën e tij me sistemin publik të largimit, grumbullimit dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, në qoftë se në zonën ku ndodhet objekti ka sistem publik të largimit dhe grumbullimit të ujërave të ndotura urbane, që administrohet nga operatori.
2. Lidhja e një prone me sistemin publik të largimit, grumbullimit dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane bëhet vetëm me miratimin e operatorit.
3. Gjatë projektimit të objekteve të reja parashikohet në projektin e ndërtimit të tyre lidhja me sistemin.
4. Kostoja e lidhjes së një prone me sistemin publik të largimit, grumbullimit dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane mbulohet nga konsumatori.

## **Neni 47**

### **Shkarkimi në sistemin publik të ujërave të ndotura urbane**

1. Çdo shkarkim në sistemin publik të ujërave të ndotura urbane në përputhje me standardet mjedisore nga persona privatë, ose publik, bëhet me miratimin e operatorit.
2. Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën dhe ministrit përgjegjës për mjedisin, miraton një rregullore të veçantë për kushtet që duhet të plotësohen për shkarkimet në sistemin publik të ujërave të ndotura urbane.

## **Neni 48**

### **Sistemet individuale të mbledhjes së ujërave të ndotura**

1. Sistemet individuale të mbledhjes së ujërave të ndotura, si impiante individuale, gropat septike, që shkarkohen më pas në sisteme kanalizimesh apo impiante trajtimi, ndërtohen me miratimin teknik të operatorit, në përputhje me standardet teknike. Personat që disponojnë sisteme të tilla i kërkojnë operatorit që mbulon zonën e shërbimit, largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, në të kundërt duhet të pajisen me leje individuale shkarkimi sipas legjislacionit përkatës.
2. Largimi i ujërave të ndotura dhe llumrave nga gropat septike bëhet nga operatori me mjete dhe makineri të posaçme, ose të shoqërive private në përputhje me marreveshjen e shërbimit të lidhur ndërmjet operatorit dhe shoqërisë private të pajisur me leje shkarkimi.
3. Kostot e largimit të ujërave të ndotura nga gropat septike mbulohen nga pronaret e objekteve.
4. Tarifat për largimin edhe heqjen e ujërave të ndotura dhe llumit të mbledhura në gropat septike dhe gropat individuale përcaktohen nga operatori në përputhje me metodologjinë përkatëse të ERRU-së.

## **Neni 49**

### **Ndarja e sistemeve të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane nga sistemet e largimit dhe grumbullimit të ujërave të shiut**

Në zonat urbane, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose organet e specializuara në qeverisjen qendore, i projektojnë dhe zbatojnë sistemet e reja të largimit, grumbullimit e trajtimit të ujërave urbane të ndotura të ndara nga sistemi i grumbullimit dhe shkarkimit të ujërave të shiut,

për të eliminuar ndikimet negative tek impiantet ekzistuese të trajtimit të ujrave të ndotura, apo ato që do të ndërtohen në të ardhmen.

## **Neni 50**

### **Ndërtimi, instalimi dhe operimi i sistemeve grumbulluese dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura për qendrat urbane**

1. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën, me mbështetjen e agjencisë kombëtare për furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin, grumbullimin e trajtimin e ujërave të ndotura urbane, bazuar edhe në programin e masave të planeve të menaxhimit të baseneve ujore, përgatit një plan kombëtar lidhur me afatet dhe burimet e financimit për ndërtimin, instalimin dhe operimin e sistemeve grumbulluese/kolektore dhe impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura për qendrat urbane sipas zonave të shërbimit.
2. Plani i përgatitur sipas pikës 1, merr parasysh përmbushjen e detyrimeve sipas praktikave më të mira, lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura urbane, gjendjen financiare të operatorëve, koston e impianteve në tarifatat e përdoruesve/klientëve të sistemit të largimit, grumbullimit e trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe burimet e financimit që do të përdoren për ndërtimin e tyre si dhe vendos detyrime të caktuara për operatorët.
2. Për hartimin e planit të përcaktuar në pikën 1, Ministria përgjegjëse për infrastrukturën i referohet programit të masave dhe objektivave mjedisore të vendosur në planin e menaxhimit të baseneve ujore dhe bashkëpunon me Ministrinë përgjegjëse për menaxhimin financiar, ERRU-në, agjencinë përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe operatorët.
3. Plani i parashikuar në pikën 1 të këtij neni miratohet nga Këshilli i Ministrave.

## **KREU VI**

### **ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ENTIT RREGULLATOR TË UJIT**

## **Neni 51**

### **Organizimi i ERRU-së**

1. Enti Rregullator i sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, është një institucion juridik, publik, i pavarur, jo buxhetor, përgjegjës për rregullimin e veprimtarisë së furnizimit me ujë të pijshëm, të

largimit, grumbullimit, dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban, që ushtron detyrat dhe kompetencat e tij, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. ERRU përbëhet nga Komisioni Kombëtar i Rregullimit, Sekretari i Përgjithshëm, këtej e tutje Komisioni dhe struktura administrative.
3. Selia e ERRU-së është në Tiranë.
4. Komisioni miraton një rregullore të veçantë për organizimin dhe funksionimin e ERRU-së, e cila publikohet në faqen zyrtare të institucionit.

## **Neni 52**

### **Kompetencat e ERRU-së**

1. ERRU-ja është përgjegjëse për kuadrin rregullator të sektorit furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
2. ERRU-ja nëpërmjet Komisionit, ushtron kompetencat e mëposhtme:
  - a) Licencon ofruesit e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit, dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban dhe miraton ndryshimin, transferimin apo heqjen e një licence, sipas rregullores së licencimit.
  - b) Harton rregulloren teknike të sektorit duke përcaktuar standardet e ofrimit të shërbimit, si dhe mbikqyr zbatimin e tyre nga të licencuarit.
  - c) Miraton planet 5 vjeçare të biznesit dhe monitoron zbatimin e tyre.
  - d) Vendos tarifatat për të licencuarit, në përputhje me metodologjitë e llogaritjes së tarifave duke siguruar, që ato janë të drejta, të përballeshme dhe që mundësojnë mbulimin e kostos dhe qëndrueshmërinë financiare të të licencuarit.
  - e) Miraton në përputhje me parashikimet e këtij ligji, aktet rregullatore, që sigurojnë mbarëvajtjen e veprimtarive të furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban.
  - f) Miraton marrëveshjet standarde të shitjes së ujit me shumicë dhe të përdorimit të rrjetit të shpërndarjes ndërmjet të licencuarve.
  - g) Siguron, në bashkëpunim me autoritete të tjera, përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit, zbatimin me efektivitet të masave mbrojtëse ndaj tyre.
  - h) Monitoron veprimtaritë e të licencuarve duke siguruar që, ato kryhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kushtet e licencës.
  - i) Mbledh të dhëna dhe informacion nga të licencuarit, në formatin dhe frekuencën e përcaktuar nga erru.

- j) Ndërmerr procedura të hetimit administrativ ndaj të licencuarve.
  - k) Shqyrton ankimet administrative, të paraqitura nga palët e interesuara, lidhur me aktet administrative individuale, të nxjerra nga erru.
  - l) Zgjidh mosmarrëveshjet, që lindin ndërmjet një të licencuari dhe konsumatorëve, apo ndërmjet të licencuarve, sipas kuadrit ligjor në fuqi.
  - m) Vendos masa administrative efektive, proporcionale dhe parandaluese ndaj të licencuarve, të cilët nuk permbushin detyrimet e tyre.
  - n) Bashkëpunon dhe aderon në organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban.
  - o) Raporton periodikisht në kuvend lidhur me zhvillimin e sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban.
3. Përveç kompetencave vendimmarrëse, të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, Komisioni ushtron edhe kompetencat e mëposhtme:
- a) Miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e ERRU-së, në zbatim të këtij ligji.
  - b) Miraton rregulloret e administrimit të përgjithshëm, si dhe përcakton mënyrat dhe procedurat e përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë së ERRU-së.
  - c) Miraton politikën e burimeve njerëzore dhe rregullat e punësimit, për stafin teknik.
  - d) Miraton kodin e etikës së ERRU-së.
  - e) Miraton ekspertin kontabël, si dhe pasqyrat financiare të ERRU-së.
  - f) Miraton nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit, të marrëveshjeve të shkëmbimit të informacionit me autoritete të tjera brenda dhe jashtë vendit.
  - g) Miraton format e raportimit të të dhënave, të detyrueshme për t'u zbatuar nga të licencuarit.
  - h) Miraton raportin e monitorimit, ku paraqitet gjendja dhe perspektiva e sektorit, i cili botohet jo më vonë se muaji korrik i çdo viti.
  - i) Miraton raportin përfundimtar të një procedure, apo hetimi administrativ.
  - j) Miraton raportin vjetor të veprimtarisë së ERRU-së, si dhe çdo raport tjetër që ERRU-ja i dërgon Kuvendit, Këshillit të Ministrave apo ministrit përgjegjës për infrastrukturën.

## **Kompetencat e kryetarit të komisionit**

1. Kryetari i Komisionit është drejtuesi ekzekutiv i institucionit. Ai është përgjegjës për administrimin e institucionit dhe drejtimin e mbledhjeve të Komisionit:
  - a) Administrimin e institucionit, përfshirë organizimin e punës së personelit dhe menaxhimin e buxhetit dhe shpenzimeve financiare të institucionit.
  - b) Thirrjen dhe drejtimin e mbledhjeve të komisionit.
  - c) Angazhimin dhe kontraktimin e shërbimit të këshillimit, nga ekspertë të fushës, për çështje të veçanta.
  - d) Urdhërimin e ngritjes së grupeve të punës, si dhe përcaktimin e objektit të punës dhe afateve të raportimit.
  - e) Nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e tjera në vend dhe entet rregullatore homologe, në vende të tjera.
2. Në rastet kur kryetari mungon në detyrë ai autorizon një nga anëtarët e komisionit, që të ushtrojë funksionin e kryetarit, gjatë kësaj periudhe.
3. Kur vendi i kryetarit të komisionit mbetet vakant, anëtari i komisionit, me kohën më të gjatë në detyrë, kryen funksionet e kryetarit, deri në emërimin e kryetarit të ri. Vjetërsia llogaritet nga data kur është emëruar, si anëtar i komisionit.
4. Për ushtrimin dhe përmbushjen e kompetencave të tij me karakter ekzekutiv, kryetari nxjerr urdhra dhe udhëzime.

### **Neni 54**

#### **Pavarësia e ERRU-së dhe konflikti i interesit**

1. ERRU-ja ushtron kompetencat, në mënyrë të paanshme, të pavarur dhe transparente.
2. Asnjë anëtar i komisionit, apo i stafit teknik të ERRU-së, nuk mund të jetë:
  - a) aksionar, ose zotërues i të drejtave të tjera pasurore, të një të licencuari në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, të largimit, grumbullimit, dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - b) anëtar i këshillit të administrimit, apo organeve të tjera drejtuese të një të licencuari në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, të largimit grumbullimit, dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban.
  - c) i punësuar me kohë të pjesshme pranë një të licencuari në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit dhe personeli teknik respektojnë legjislacionin në fuqi lidhur me konfliktin e interesit. Nëse gjatë procedurave të parashikuara, sipas këtij ligji, një anëtar i komisionit, ose i stafit teknik gjendet në një situatë të konfliktit të interesit, në kuptimin e ligjit të parandalimit të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, ai nuk merr pjesë në shqyrtimin dhe procedurën përkatëse.

### **Neni 55** **Komisioni, përbërja dhe emërimi i anëtarëve të tij**

1. Komisioni përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë që emërohen nga Kuvendi, mbështetur në propozimin e ekipit përzgjedhës.
2. Ekipi përzgjedhës i kandidatëve, për anëtarë të komisionit përbëhet nga tre përfaqësues, dy prej të cilëve janë përfaqësues të Kuvendit, përkatësisht, kryetari i Komisionit të Përhershëm Parlamentar të Veprimtarive Prodhuese, Tregëtisë dhe Mjedisit, dhe kryetari i Komisionit të Përhershëm Parlamentar të Ekonomisë dhe Financës, dhe i treti, është ministri përgjegjës për infrastrukturën.
3. Ekipi përzgjedhës i merr vendimet me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të tij. Përzgjedhja e kandidatëve, për anëtarë komisioni, nga ekipi përzgjedhës bëhet me procedurë konkurruese.
4. Jo më vonë se 6 muaj, përpara mbarimit të mandatit, të njërit prej anëtarëve të komisionit, kryetari i komisionit njofton ekipin përzgjedhës për mbarimin e mandatit. Me marrjen e njoftimit dhe jo më vonë se 1 muaj nga marrja e tij, Kuvendi publikon njoftimin për vendin vakant. Ekipi përzgjedhës, nis procedurën e përzgjedhjes së anëtarit të komisionit dhe jo më vonë se 3 muaj, përpara mbarimit të mandatit të njërit prej anëtarëve të komisionit, ekipi përzgjedhës, dërgon 2 kandidatët, që kanë pikët më të larta, për votim pranë Kuvendit, i cili emëron kandidatin me më shumë vota. Në rast se në procesin e përzgjedhjes, është parqitur vetëm një kandidat, ose vetëm një prej kandidatëve të paraqitur, plotëson kriteret e parashikuara në pikën 5, të këtij neni, ekipi përzgjedhës dërgon për votim, pranë Kuvendit, kandidatin e kualifikuar. Kuvendi, në këtë rast rrëzon, ose emëron kandidaturën e paraqitur.
5. Kryetari dhe anëtarët e komisionit janë persona, që kanë përfunduar studimet universitare dhe kanë eksperiencën e mëposhtme:
  - a) kryetari i komisionit duhet të jetë një person me karrierë të shquar profesionale, mundësisht në sektorin e ujit, me jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet eksperiencë pune, në një, apo më shumë nga disiplinat e përshkruara, në shkronjën b, c dhe d të kësaj pike.



- b) një anëtar duhet të jenë profesionist i kualifikuar, me diplomë universitare në inxhinieri ndertim dhe ose hidroteknik, ose mjedisi dhe me jo më pak se dhjetë vjet eksperiencë pune në profesion.
  - c) një anëtar duhet të jenë profesionist i kualifikuar, që të ketë përfunduar studimet në fushën e shëndetit publik dhe me jo më pak se dhjetë vjet eksperiencë pune në profesion.
  - d) Një anëtar duhet të jetë profesionist i kualifikuar, me diplomë universitare në drejtësi dhe me jo më pak se dhjetë vjet eksperiencë pune në profesion.
  - e) Një anëtar duhet të jetë profesionist i kualifikuar me diplomë universitare në shkencat ekonomike dhe me jo më pak se dhjetë vjet eksperiencë pune në profesion.
  - f) një anëtar duhet të jenë profesionist i kualifikuar, me diplomë universitare në inxhinieri, hidrogeolog ose mjedis dhe me jo më pak se dhjetë vjet eksperiencë pune në profesion.
6. Çdo anëtar i komisionit, përfshirë kryetarin, emërohet për një mandat pesë vjeçar, me të drejtë rimerimi, vetëm për një mandat të dytë, rradhazi.
7. Nuk mund të zgjidhet anëtar i komisionit:
- a. personi, bashkëshorti, ose të afërm deri në shkallë të dytë, të anëtarit të ekipit përzgjedhës.
  - b. personi që nuk plotëson kushtet e përcaktuara në ligjin në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen emërohen, ose ushtrojnë funksione publike.
8. Në rast se një nga anëtarët e komisionit shkarkohet apo lirohet nga detyra, Kuvendi publikon njoftimin për vendin vakant. Ekipi përzgjedhës, nis procedurën e përzgjedhjes së anëtarit të komisionit dhe jo më vonë se tre muaj, përpara mbarimit të mandatit të njërit prej anëtarëve të Komisionit, ekipi përzgjedhës, dërgon dy kandidatët, që kanë pikët më të larta, për votim pranë Kuvendit, i cili emëron kandidatin me më shumë vota. Në rast se në procesin e përzgjedhjes, është paraqitur vetëm një kandidat, ose vetëm një prej kandidatëve të paraqitur, plotëson kriteret e parashikuara në pikën 5, të këtij neni, ekipi përzgjedhës dërgon për votim, pranë Kuvendit, kandidatin e kualifikuar. Kuvendi, në këtë rast rrëzon, ose emëron kandidaturën e paraqitur.
9. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit të ri, të përzgjedhur sipas pikës 8 të këtij neni, do të jetë e njëjtë me kohën e mbetur, të mandatit të anëtarit, që është shkarkuar, apo liruar.

**Neni 56**  
**Mbledhjet dhe vendimet e komisionit**

1. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij si organ kolegjal, vendimmarrës i ERRU-së, sipas këtij ligji, si dhe rregullores së funksionimit të ERRU-së.
2. Mbledhjet vendimmarrëse dhe seancat dëgjimore të komisionit janë të hapura. Në raste të veçanta, që kanë të bëjnë me trajtimin e çështjeve me karakter të brendshëm, komisioni mund të zhvillojë mbledhje me dyer të mbyllura, në përputhje me përcaktimet e rregullores së funksionimit.
3. Numri i nevojshëm i anëtarëve për të arritur kuorumin vendimmarrës, në një mbledhje të komisionit, është jo më pak se tre. Komisioni i merr vendimet me shumicë të anëtarëve të tij, pjesëmarrës në mbledhje. Në rast të votave të barabarta, vota e kryetarit është përcaktuese.
4. Komisioni merr vendime vetëm për çështjet, të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje të tjera, që nuk janë në rendin e ditës.
5. Të gjitha vendimet e komisionit duhet të jenë qartësisht të arsyetuara.
6. Të gjitha vendimet e komisionit, përveç atyre që kanë të bëjnë me çështjet e brendshme të ERRU-së, publikohen në Fletoren Zyrtare. ERRU-ja publikon një raport argumentues të hollësishëm, i cili përfshin bazën ligjore dhe argumentat për vendimin e komisionit, përfshirë sqarimin e pozicioneve thelbësore të palëve, të përfshira në çështjen e shqyrtuar.
7. Çdo palë e përfshirë në një procedurë, mund t'i kërkojë ERRU-së brenda shtatë ditëve kalendarike, nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të komisionit, në rast se ka siguruar prova të reja, që mund ta çojnë komisionin, në marrjen e një vendimi të ndryshëm, nga i mëparshmi.
8. Të gjitha vendimet e komisionit, nuk do të jenë objekt rishikimi nga asnjë organ tjetër publik, përveç rishikimit gjyqësor.
9. Çdo vendim i komisionit mund të ankimohet në gjykatën administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, duke filluar nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare.

### **Neni 57**

#### **Shkarkimi dhe lirimi nga detyra i anëtarëve të komisionit**

1. Çdo anëtar i komisionit, përfshirë kryetarin, mund të shkarkohet nga detyra nga Kuvendi, vetëm në rast se:
  - a. Gjatë ushtrimit të funksionit, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, apo akte të tjera ligjore e nënligjore.

- b. Dënohet për kryerjen një vepre penale me një vendim gjykate të formës së prerë.
  - c. Pa ndonjë shkak të arsyeshëm refuzon, apo nuk kryen detyrën, për një periudhë mbi 3 muajsh.
2. Çdo anëtar i komisionit, përfshirë kryetarin, lirohet nga detyra nga Kuvendi, kur:
    - a. Përfundon plotësisht mandatin dhe nuk mund të rizgjidhet më, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
    - b. Jep dorëheqjen e parevokueshme.
    - c. Kandidon për t'u bërë deputet i kuvendit, apo i zgjedhur i një njësie vendore.
    - d. Për arsye shëndetësore, ose të justifikuara ligjërish, bëhet i paaftë për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e tij, për një periudhë mbi gjashtë muaj.
  5. Shkarkimi, ose lirimi i anëtarit të komisionit, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, bëhet me me propozim të ekipit përzgjedhës dhe miratim të Kuvendit.
  6. Përpara marrjes së vendimit përfundimtar për shkarkimin nga detyra anëtarit, apo kryetarit të komisionit i jepet mundësia për të parashtruar pretendimet e tij, para komisionit të përhershëm parlamentar të veprimtarive prodhuese, tregëtisë dhe mjedisit dhe komisionit të përhershëm parlamentar të ekonomisë dhe financës.
  7. Çdo anëtar, i cili është shkarkuar nga detyra sipas pikës 1 të këtij neni, nuk ka të drejtë të rizgjidhet në komision, përveç rastit kur vendimi i shkarkimit, shfuqizohet me një vendim gjyqësor të formës së prerë.
  8. Në rastet e përfundimit të mandatit të kryetarit, apo një anëtarit të komisionit, ai vazhdon të jetë në detyrë, deri datën e fillimit të ushtrimit të detyrës nga kryetari, apo anëtarit i ri i emëruar nga Kuvendi.

### **Neni 58** **Stafi teknik dhe këshillues**

1. Stafi teknik ndihmon komisionin në kryerjen e detyrave të tij. Stafi teknik përzgjidhet, emërohet, ngrihet në detyrë dhe largohet nga detyra nga komisioni, sipas kritereve dhe procedurave të miratuara prej tij.
2. Përveç stafit teknik të përhershëm, komisioni mund të marrë vendim për të punësuar, kur e sheh të arsyeshme, ekspertë ose këshilltarë të jashtëm, të përkohshëm, për të mbështur ERRU-në në detyra specifike, për të cilat mungon ose është e limituar ekspertiza e stafit teknik.

3. Kostot lidhur me pagesën ekspertëve dhe këshilltarëve të jashtëm, të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, mbulohen nga buxheti i ERRU-së.

### **Neni 59** **Buxheti dhe financimi i ERRU-së**

1. ERRU ka autonomi të plotë në përdorimin e buxhetit të saj.
2. Burimet e financimit të ERRU-së përbëhen nga:
  - a. Pagesat për pajisjen me licencë.
  - b. Pagesat vjetore të rregullimit, që paguhen nga të licencuarit.
  - c. Donacione të ndryshme, të përfituara sipas legjislacionit në fuqi.
3. ERRU përcakton dhe miraton pagesat vjetore, rregullatore, që paguhen prej të licencuarve. Paguesa do të përcaktohet në përputhje me kriteret e parashikuara, në metodologjinë e vendosjes së tarifave dhe duhet të jetë në përputhje të drejtë me të ardhurat vjetore, që vijnë nga veprimtaria e licencuar.
4. Kur ERRU përcakton pagesat vjetore rregullatore, njofton të licencuarin mbi vlerën dhe afatet e pagesës. Nëse i licencuari nuk kryen pagesën brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së njoftimit, ERRU ka të drejtë të aplikojë masat administrative, në përputhje me nenin 75, të këtij ligji, përfshirë edhe heqjen e licencës.
5. Pagesat për pajisjen me licencë dhe ato rregullatore depozitohen në llogarinë e ERRU-së.
6. Çdo fond në llogarinë e ERRU-së, që nuk shpenzohet gjatë vitit ushtrimor financiar, transferohet për vitin pasardhës, duke reduktuar proporcionalisht pagesat rregullatore për vitin pasardhës.
7. ERRU mban llogari të detajuara mbi shpenzimet e kryera. Auditimi i veprimtarisë financiare të ERRU-së, kryhet nga ekspertë të miratuar kontabël, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 60** **Struktura, pagat dhe marrëdhëniet e punës**

1. Struktura organizative e ERRU-së propozohet nga kryetari dhe miratohet nga komisioni.
2. Marrëdhëniet e punës së stafit teknik rregullohen nga kodi i punës.
3. Pagat dhe të gjitha trajtimet financiar të anëtarëve dhe kryetarit të komisionit përcaktohen nga komisioni.

4. Pagat dhe të gjitha trajtimet financiare të stafit teknik përcaktohen nga Komisioni.

#### **Neni 61 Raportimi**

1. ERRU paraqet në Kuvend, brenda katër muajve të parë të vitit pasardhës, raportin vjetor të veprimtarisë së vitit pararendës. Një kopje e raportit i dërgohet ministrit përgjegjës për infrastrukturën.
2. Raporti vjetor duhet të përmbajë në mënyrë të veçantë:
  - a. Përshkrim analitik të situatës në sektorit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, të realizimit të treguesve të performancës nga të licencuarit, si dhe objektivat për vitin në vazhdim.
  - b. Informacion lidhur me veprimtarinë e erru-së gjatë vitit paraardhës.
  - c. Programin vjetor të punës për vitin në vazhdim.
  - d. Informacion për realizimin e treguesve financiarë vjetorë të erru-së, si dhe gjetjet e raportit të auditimit financiar.
3. Kuvendi shqyrton raportin e ERRU-së dhe me anë të një rezolute bën vlerësimin e veprimtarisë, si dhe rekomandimet përkatëse për vitin në vazhdim. Raporti vjetor dhe rezoluta e Kuvendit publikohen në Fletoren Zyrtare dhe në faqen zyrtare të ERRU-së.
4. ERRU i paraqet Kuvendit dhe ministrit përgjegjës për infrastrukturën, çdo informacion të nevojshëm mbi situatën dhe zhvillimet në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, sa herë që kjo kërkohet.

#### **Neni 62 Aksesi i publikut në informacion**

1. Çdo dokumentacion i arkivuar apo që administrohet nga ERRU është i hapur për publikun në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit.
2. Gjatë bërjes publike të informacionit të kërkuar sipas pikës 1, të këtij neni, ERRU ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, për të licencuarit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 63 Veprimtaritë e licencuara dhe përjashtimet**

1. Veprimtaritë në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane për interes publik, objekt i këtij ligji, kryhen nga operatorët, të pajisur me licencën përkatëse.
2. ERRU licencon operatorët, për veprimtaritë e mëposhtme:
  - a) Grumbullimin dhe trajtimin e ujit të pijshëm;
  - b) Shitjen me shumicë të ujit të pijshëm;
  - c) Shpërndarjen dhe furnizimin e ujit për konsum publik;
  - d) Grumbullimin dhe largimin e ujërave të ndotur urban.
  - e) Përpunimin e ujërave të ndotur urban
3. Operatorët pajisen me licencë për kryerjen e secilës veprimtari, të parashikuar në pikën 2, të këtij neni.
4. Pajisja me licencë për grumbullimin dhe trajtimin e ujit të pijshëm sipas shkronjës a, të pikës 2, të këtij neni, nuk e shmang mbajtësin e licencës nga detyrimi për t'u pajisur me autorizimin për përdorimin e burimit ujqor, sipas ligjit për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, në fuqi.  
Pajisja me licencë për largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotur urban sipas shkronjës "d", të pikës 2, të këtij neni, nuk e shmang mbajtësin e licencës nga detyrimi për t'u pajisur me lejet dhe licencat e nevojshme sipas përcaktimeve në kuadrin ligjqor në fuqi, të fushës së mjedisit, për grumbullimin, transportin, magazinimin apo përpunimin e ujërave të ndotur urban.
5. Licencat për veprimtaritë e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni u jepen mbajtësve të tyre mbi baza të territorit administrativ të njërive të qeverisjes vendore, me përjashtim të rastit kur dy ose më shumë njësi të qeverisjes vendore kanë një marrëveshje, që këto shërbime të ofrohen nga një i licencuar i vetëm.
6. Nuk kërkohet që të pajisen me licencë, sipas këtij neni, përdoruesit e puseve, apo burimeve të ngjashme individuale, të furnizimit me ujë, të cilat nuk përdoren për qëllim fitimi.

#### **Neni 64**

#### **Kushtet e licencimit**

1. Çdo person juridik mund të aplikojë dhe kërktojë të pajiset me licencë sipas nenit 63, të këtij ligji, në qoftë se ai i përmbush kushtet e mëposhtme:
  - a. Ka një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë.
  - b. Ka aftësitë e nevojshme tekniko-profesionale.
  - c. Ka aftësitë financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, për të cilën kërkon të aplikojë.

- d. Ka përvojë të mjaftueshme në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, të largimit, grumbullimit, dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban.
  - e. Nuk është i dënuar për kryerjen e një veprë penale.
  - f. Nuk është në proces likuidimi, apo falimentimi, apo në një situatë paaftësie financiare, lidhur me detyrimet, që ka ndaj të tretëve.
  - g. I është revokuar, ose hequr licenca, dhe nuk ka perfunduar periudha brenda të cilës, është i ndaluar riaplikimi për licencë, siç është përcaktuar në vendimin përkatës të ERRU-së për heqjen e licencës.
2. ERRU mund të kërkojë prova, të dhëna dhe dokumenta përkatës në përputhje me rregulloren e licensimit, që nevojiten për të verifikuar, që aplikuesi përmbush të gjitha kushtet për pajisjen me licencë.

### **Neni 65 Procedura e licensimit**

1. Komisioni miraton një rregullore lidhur me procedurat licensimit, e cila përcakton afatet dhe kushtet lidhur me dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e një licence, pagesat e aplikimeve për licencë, si dhe informacionin, dokumentacionin që duhet paraqitur, në kërkesën për aplikim, për secilën prej veprimtarive të licensuara.
2. Procedurat e licensimit janë transparente dhe sigurojnë trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë aplikuesit. Rregullorja për procedurat e licensimit botohet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen zyrtare të ERRU-së.

### **Neni 66 Aplikimi për licencë**

1. Për çdo aplikim për marrjen e një licence, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, ERRU-ja publikon brenda 10 ditëve kalendarike nga kryerja e aplikimit, njoftimin për aplikimin e bërë për dhënie licence, në përputhje me mënyrën e përcaktuar në rregulloren për procedurat e licensimit.
2. ERRU publikon aplikimin në faqen zyrtare të tij, në përputhje me ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik.
3. ERRU merr vendim për dhënien, ose jo të licencës, brenda gjashtëdhjetë ditëve nga data e aplikimit, përveç rastit kur mund të vendosë zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit, në

përputhje me rregulloren e funksionimit të saj. Në çdo rast, zgjatja e afatit të marrjes së vendimit nuk mund të jetë më shumë se tridhjetë ditë.

### **Neni 67** **Refuzimi i dhënies së licencës**

1. ERRU refuzon dhënien e licencës, nëse aplikuesi nuk përmbush ndonjë nga kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 64 të këtij ligji, si dhe kërkesat parashikuara ne rregulloren e licencimit. Vendimi i ERRU-së specifikon arsyet për refuzimin.
2. Kur ERRU vlerëson se mosplotësimi i kushteve të parashikuar në nenin 64, nuk është thelbësor dhe mund të korrigohet, ajo mund të japë licencën, me kusht që i licencuari të përmbushë kushtin e paplotësuar brenda periudhës të përcaktuar nga ERRU-ja.

### **Neni 68** **Heqja licencës**

1. ERRU i heq licencën, të licencuarit kur:
  - a. Nuk përmbush në mënyrë të vazhdueshme kushtet thelbësore të licencës.
  - b. Nuk përmbush kushtet e shërbimit sipas nenit 27 të këtij ligji.
  - c. Shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij.
  - d. Rrezikon nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve, jetën dhe shëndetin e popullatës.
  - e. Rrezikon nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve dëmtimin e burimit ujor.
  - f. Bëhet financiarisht i paaftë, ose fillon procedurat e falimentimit.
  - g. Me kërkesë të vetë licencuarit.
  - h. Ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara të parashikuara sipas licencës.
  - i. Nuk përmbush kushte, të përcaktuar në rregulloren e procedurave të licencimit.
2. Rregullorja e procedurave të licencimit përmban rregulla të detajuara, mbi kushtet e licencimit, si dhe procedura të veçanta për heqjen licencës, që përcaktojnë detyrimisht, por nuk limitohen në detyrimin e ERRU-së për:
  - a. Njoftimin me shkrim të të licencuarit, mbi fillimin e procesit për heqjen e licencës, i cili përmban arsyet për fillimin e procesit.
  - b. T'i dhënë mundësinë të licencuarit të përgjigjet me shkrim, brenda 30 ditëve, nga marrja e njoftimit.



- c. T'i dhënë mundësinë të licencuarit që, brenda tridhjetë ditë pas përgjigjes së tij me shkrim, që të veprojë në përputhje me termat dhe kushtet e licencës dhe të shmangë shkakun për heqjen e licencës.
3. Kur ERRU vendos heqjen e një licence, në konsultim me ministri përgjegjëse për infrastrukturën dhe cakton operatorin e alternativës së fundit për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban, duke përzgjedhur një nga format e parashikura në pikën 2, të nenit 26 të këtij ligji.
  4. Rregullat, procedurat dhe kriteret për zbatimin e kërkesave të parashikuara në pikën 3, të këtij neni, përcaktohen nga ERRU-ja, në rregulloren e licencimit, brenda gjashtë muajve, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

### **Neni 69** **Ndryshimi i kushteve të licencës**

1. Çdo i licencuar mund t'i kërkojë ERRU-së ndryshimin e kushteve të licencës. ERRU-ja miraton kërkesën e të licencuarit, vetëm nëse, ndryshimet e kërkuara, nuk ndikojnë në cilësinë e ofrimit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, që i licencuari ka në përputhje me këtë ligj, si dhe me kushtet e licencës së tij.
2. Përpara miratimit të ndryshimit të kushteve të licencës, me kërkesën e të licencuarit, ERRU-ja publikon ndryshimet e propozuara, në faqen zyrtare të saj, në përputhje me ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik.
3. ERRU mund të kërkojë ndryshimin e kushteve të licencës, kur ndryshojnë aktet ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban.
4. Rregullorja e procedurave të licencimit përmban rregulla të detajuara, mbi ndryshimin e kushteve të licencës.

### **Neni 70** **Veprimtaritë me tarifa të rregulluara**

1. Operatorët aplikojnë për vendosjen e nivelit të ri tarifor, pranë ERRU-së, për gjitha veprimtaritë e licencuara, sipas nenit 63 të këtij ligji.
2. ERRU brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton metodologjinë dhe rregulloren e procesit të vendosjes së tarifave, për veprimtaritë e licencuara.

3. Metodologjia dhe rregullorja e procesit të vendosjes së tarifave për veprimtaritë e licencuara mbështetet në parimet e:
  - a. Mbulimit të kostove, përfshirë dhe një normë kthimi të arsyeshme të kapitalit të investuar, duke nxitur qendrueshmërinë financiare të operatorëve.
  - b. Përballueshmërisë dhe të aftësisë paguese të konsumatorëve.
  - c. Kostove të justifikuara të operimit dhe mirëmbajtjes, si dhe të investimeve, që janë miratuar, si varianti më i mirë, bazuar në kriteret tekniko ekonomike të përzgjedhjes së tyre.
  - d. Ndalimit të ndërsbvencionimit të veprimtarive të tjera ekonomike, që i licencuari mund të kryejë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.
  - e. Transparencës dhe mosdiskriminimit ndaj të gjithë konsumatorëve, që ndodhen në zonën e shërbimit të një të licencuari. Niveli i tarifave nuk ndikohet nga distanca e konsumatorit me sistemin e furnizimit me uje te pijshem, apo sistemin e largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - f. Mundësimin të kryerjes së investimeve të nevojshme, për ofrimin e shërbimit optimal, në sistemin e furnizimit me ujetë pijshëm , apo sistemin e largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - g. Nxitjes së të licencuarve për arritjen e objektivave të treguesve të performancës, si dhe rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.
  - h. Miratimit në heshtje. Në çdo rast procedura e shqyrtimi të tarifës nuk mund të zgjasë më shumë se katër muaj, nga data e aplikimit. Me kalimin e periudhës katër mujore, nëse ERRU-ja nuk shprehet për refuzimin apo miratimin e saj, tarifa e propozuar nga operatori dhe miratuar nga organet drejtuese të operatorit dhe në cdo rast në përputhje me formën ligjore që është krijuar operatori, brenda juridiksionit ku ushtron veprimtarinë i licencuari, hyn automatikisht në fuqi.
4. Çdo i licencuar i bën publike tarifat e miratuara, për konsumatorët e tij, të paktën tridhjetë ditë përpara hyrjes së tyre në fuqi

## **Neni 71** **Rishikimi i tarifave**

1. Rishikimi i tarifave bëhet me kërkesën e të licencuarit, ose dhe kryesisht, me iniciativën e ERRU-së. Kur ERRU, me iniciativën e vet vlerëson se rishikimi i tarifës është i domosdoshëm, për të mbuluar kostot dhe brenda limiteve të aftësisë paguese të

konsumatorëve, nxjerr vendim urdhërues për operatorët, për aplikimin e tarifës së miratuar. Ky vendim dërgohet për miratim në organet drejtuese te operatorit.

2. Në rast se organet drejtuese te operatorit nuk miratojnë hyrjen në fuqi të tarifës së miratuar paraprakisht nga ERRU-ja, aksionerët e operatorit janë të detyruar të argumentojnë arsyet e mos miratimit, si dhe planin e mbulimit të kostos për diferencën e tarifës së propozuar nga ERRU dhe asaj të propozuar nga organet drejtuese te operatorit. Plani i mbulimit të kostos reflektohet në buxhetin e njësisë vetëqeverisjes vendore përkatëse për vitin buxhetor pasardhës si dhe në planin buxhetor afatmesëm me destinacion operatorin e ofrimit të shërbimit. Aplikimi, rishikimi dhe miratimi i tarifave bëhet sipas rregullave të veçanta, të rregullores së parashikuar në pikën 2, të nenit 70, të këtij ligji.
3. Rregullat e miratuara sipas pikës 1 të këtij neni, mbajnë parasysht se:
  - a. rishikimi i tarifave nuk mund të bëhet më shumë se një herë, brenda një viti financiar, përveç rasteve kur ERRU e lejon këtë, pas paraqitjes së një arsyetimi të bazuar.
  - b. ERRU mbikqyr procesin e konsultimit publik gjatë seancave dëgjimore që organizon i licencuari përpara propozimit për nivel të ri tarifor pranë ERRU-se. organizon procesin e konsultimit publik gjatë seancave dëgjimore që organizon i licencuari në përputhje me ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik, në fuqi.

## **Neni 72** **Monitorimi**

1. ERRU monitoron në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e të licencuarve lidhur me zbatimin e tarifave të miratuara prej saj, si dhe përmbushjen e kushteve të licencës. ERRU miraton rregulla dhe formate të veçanta, të raportimit nga të licencuarit.
2. ERRU monitoron në veçanti:
  - a. Arritjen e kushteve të shërbimit sipas nenit 27 të këtij ligji.
  - b. Zbatimin e planit të biznesit pesë vjeçar të aprovuar nga ERRU-ja, që përfshin dhe progresin e realizimit të investimeve kapitale në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm, apo sistemin e largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.
  - c. Mbajtjen e llogarive të ndara, për shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm, nga ato të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban.
  - d. Informimin e konsumatorëve lidhur me tarifatat e shërbimeve, procedurat dhe tarifatat e lidhjeve të reja, kufizimet e ofrimit të shërbimit, për shkaqe objektive, teknike, afatet

për riparimet në sistemin e furnizimit me uje, apo sistemin e largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.

e. Procesin e shqyrtimit të ankesave kundrejt operatorëve.

### **Neni 73** **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. ERRU vepron si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura midis të licencuarve. Në lidhje me ankesat e paraqitura nga konsumatorët ndaj të licencuarve, si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të veprojë një strukturë e posaçme brenda ERRU-së.
2. Në lidhje me ankesat e paraqitura nga konsumatorët ndaj të licencuarve, si autoritet për trajtimin dhe zgjidhjen e tyre do të veprojë një strukturë e posaçme brenda ERRU-së.
3. ERRU, si autoritet i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, merr vendim brenda një afati prej dy muajve nga marrja e ankesës. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në dy muaj të tjerë, në rastet kur ERRU i nevojitet informacion shtesë.
4. Paraqitja e ankesës sipas parashikimeve të këtij neni e cila nuk pranohet nga ERRU sipas nje vendimi i jep të drejtën palës së interesuar për t'ju drejtuar organeve të tjera kompetente administrative, ose gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. ERRU ka detyrimin të njoftojë të licencuarin për ankesën e paraqitur ndaj tij duke i dhënë mundësinë e pergjigjes së tij ndaj ankesës. Procedura e ankimimit do të bëhet në përputhje me Kodin i Procedurave Administrative.
6. Vendimi i ERRU-së është i detyrueshëm për zbatim prej palëve, pervecse kur pezullohet ose anulohet me vendim gjykate.

### **Neni 74** **Hetimi administrativ**

1. ERRU, në ushtrim të kompetencave të parashikuara në nenin 52 të këtij ligji, ka të drejtë të kryejë hetim administrativ.
2. ERRU brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, miraton rregulla të veçanta, për kryerjen e hetimit administrativ, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

## **KREUVII** **KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE**

## **Neni 75**

### **Sanksionet administrative**

1. Lidhjet e paautorizuara të konsumatorëve familjarë, në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm, ose në sistemin e largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, kur nuk përbëjnë vepër penale, gjobiten nga operatorët me gjobë, në vlerën nga 50.000 lekë, deri në 100.000 lekë.
2. Lidhjet e paautorizuara të konsumatorëve publikë, ose privatë në sistemin e furnizimit me ujë, ose në sistemin e largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban, kur nuk përbëjnë vepër penale, gjobiten nga operatorët me gjobë, në vlerën nga 100.000 lekë, deri në 500.000 lekë.
3. Përdorimi i ujit të pijshëm për aktivitete ekonomike, pa u pajisur me lejet, apo dhe autorizimet përkatëse, gjobiten nga operatorët me gjobë në vlerën nga 500.000 lekë, deri në 1.000.000 lekë.
4. Përdorimi i ujit për aktivitete të ujitjes, apo aktivitete të tjera të ngjashme gjobiten nga operatorët me gjobë në vlerën nga 100.000 lekë, deri në 500.000 lekë.
5. Regjistrimi i konsumatorëve publik, apo privat, si konsumatorë familjar, gjobitet nga operatorët me gjobë në vlerën nga 300.000 lekë, deri 1.000.000 lekë. Gjoha në këtë rast aplikohet ndaj ushtruesit të veprimtarisë, nëse ky i fundit është i ndryshëm nga pronari i objektit.
6. Gjobat e vendosura nga operatorët sipas pikës 1, deri në pikën 5, të këtij neni derdhen në buxhetin e operatorit dhe përdoren me destinacion përmirësimin e ofrimit të shërbimit në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urban, në përputhje me aktivitetet e parashikuara në planin e biznesit.
7. Shkeljet e mëposhtme, të kryera prej të licencuarve, kur nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen nga ERRU-ja me gjobë, nga 0,5 përqind, deri në 3 përqind, të të ardhurave, të vitit paraardhës, të të licencuarit:
  - a. Aplikimi i tarifave të ndryshme, nga ato të miratuara nga ERRU.
  - b. Moszbatimi i ndonjë vendimi urdhërues të erru-së.
  - c. Mosparaqitja e pasqyrave financiare.
  - d. Refuzimi i paraqitjes së të dhënave dhe raporteve periodike, o dërgimi me vonesë i tyre, ose dërgimi i të dhënave të pasakta.
  - e. Mospublikimi i informacionit për tarifatat e shërbimit.

- f. Shkelja e kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në licencë.
  - g. Moskryerja e pagesës rregullatore nga të licencuarit brenda afatit të përcaktuar.
  - h. Moszbatimi i vendimeve të ERRU-së për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
8. ERRU-ja brenda gjashtë mujave nga hyrja në fuqi të këtij ligji, harton dhe miraton një rregullore të veçantë, lidhur me kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave.
9. Gjocat e vendosura nga ERRU-ja, sipas këtij neni, derdhen në Buxhetin e Shtetit me destinacion sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane.

#### **Neni 76**

##### **Ankimi**

1. Konsumatorët e gjobitur nga operatorët, sipas pikës 1, 2, 3, 4, 5, të nenit 75, të këtij ligji, kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre pranë ERRU-së, brenda 30 diteve nga data e gjobitjes. Procedura e ankeses bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.
2. Të licencuarit e gjobitur nga ERRU-ja, sipas pikës 7, të nenit 75, të këtij ligji, mund ta ankimojnë vendimin për gjobë, në gjykatën administrative Tiranë.
3. Kryetari i njësisë vendore, i gjobitur nga ERRU-ja, sipas pikës 8, të nenit 75, të këtij ligji, mund ta ankimojnë vendimin për gjobë, në gjykatën administrative Tiranë.

#### **Neni 77**

##### **Ekzekutimi i kundravajtjeve administrative**

1. Është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile:
  - a. Vendimi i ERRU-së, për vendosjen e gjobës ndaj të licencuarve, sipas pikës 7, të nenit 75, të këtij ligji.
  - b. Vendimi i operatorëve, për vendosjen e gjobës ndaj konsumatorëve, sipas pikës 1, 2, 3, 4, 5, të nenit 75, të këtij ligji.

### **KREU VIII DISPOZITA TË TJERA**

#### **Neni 78**

##### **Të drejtat e pronësisë**

1. Për sigurinë e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, operatorët mund të kërkojnë përdorimin e njëres prej të drejtave të mëposhtme mbi pronën që nevojitet:

- a. Të drejtën e servitutit për shtrirjen e linjave të ujësjellësit dhe ndërtimin e kanaleve për largimin e ujrave të ndotur urban;
  - b. Të drejtën e marrjes në përdorim të përkohshëm, të pasurive pronë private;
  - c. Shpronësimin e pasurive pronë private.
2. Kur ushtrohen të drejtat, sipas pikës 1 të këtij neni, dëmet e shkaktuara nga vendosja e shenjave, matjeve, testeve, ose instalimi i pajisjeve, aksesit në to, kryerja e punës në to, si dhe pengimi ose kufizimi i përdorimit të pronës, i rimbursohen pronarit, ose përdoruesit të pronës nga operatorët, në përputhje me Kodin Civil dhe legjislacionin për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik.
  3. Në zonat e mbrojtura natyrore, të drejtat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, jepen me miratimin paraprak të institucionit përgjegjës për zonën e mbrojtur, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për zonat e mbrojtura.
  4. Në rast të përfundimit të të drejtave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, operatorët, risjell pronën e përdorur, në gjendjen e mëparshme.
  5. Kur konsumatori ndodhet në një ndërtesë me shumë apartamente banimi, ose strukturë me disa biznese, operatori ka të drejtë të ushtrojë të gjitha të drejtat lidhur me shtrirjen e tubacionit, përdorimin, riparimin, ndërtimin, servitutit dhe shpronësimin në atë ndërtesë, të cilat janë të nevojshme, për furnizimin me ujë të këtij konsumatori, deri tek vendndodhja e ujë matësit.

## **Neni 79**

### **Miratimi i akteve nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që brenda 12 muajsh, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, kur nuk parashikohet një afat i ndryshëm në nenin përkatës.
2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për infrastrukturën, ministritë e linjës, si dhe agjencia kombëtare, përgjegjëse për furnizimin me ujë, largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane, që brenda 12 muajsh, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, kur nuk parashikohet një afat i ndryshëm në nenin përkatës.
3. Ngarkohet ERRU, që brenda 12 muajsh, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, kur nuk parashikohet një afat i ndryshëm në nenin përkatës.

**Neni 80**  
**Dispozita tranzitore**

1. Ligji nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura” të ndryshuar dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji shfuqizohet.
2. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të ERRU-së, të cilët kryejnë këtë funksion në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të kryejnë funksionin, deri në përfundimin e mandatit të tyre, të marrë sipas ligjit nr.8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura” të ndryshuar.
3. Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, të largimit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur urban, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen, për aq sa janë të aplikueshme, deri në rishikimin e tyre, ose dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.

**Neni 81**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.